

Raporti i Departamentit të Kontrollit Financiar të Kishës, 2013

Paraqitur nga Kevin R. Xhergensen,
Drejtor Administrimi, Departamenti i Kontrollit Financiar të Kishës

Drejtuar Presidencës së Parë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Të dashur Vëllezër: Siç përshkruhet me anë të zbulës në seksionin 120 të Doktrinës e Besëlidhjeve, Këshilli mbi Planifikimin e Të Dhjetave – i përbërë nga Presidenca e Parë, Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve dhe Peshkopata Kryesuese –autorizon shpenzimin e fondeve të Kishës. Subjektet e Kishës i shpenzojnë fondet në përputhje me buxhetet, politikat dhe procedurat e miratuara.

Departamenti i Kontrollit Financiar të Kishës, i cili përbëhet nga profesionistë të licencuar dhe është i pavarur nga të gjitha departamentet e tjera të Kishës, ka përgjegjësinë të kryejë kontrole financiare me qëllim që të japë siguri të arsyeshme në lidhje me kontributet e marra, shpenzimet

e bëra dhe mbrojtjen e pasurive të Kishës.

Bazuar mbi kontrollet financiare të kryera, Departamenti i Kontrollit Financiar të Kishës është i mendimit se, në çdo hollësi të rëndësishme, kontributet e marra, shpenzimet e bëra dhe pasuritë e Kishës për vitin 2013, janë regjistruar dhe administruar në harmoni me buxhetet, politikat dhe praktikatat llogaritëse të miratuara të Kishës. Kisha ndjek praktikatat që u jepen mësim anëtarëve të saj të jetuarit brenda një buxheti, të shmangies së borxhit dhe kursimit për një rast nevojë.

I paraqitur me respekt nga
Departamenti i Kontrollit të Kishës
Kevin R. Xhergensen
Drejtor Administrimi ■

Raporti Statistikor, 2013

Paraqitur nga Bruk P. Hejls,
Sekretar i Presidencës së Parë

Për informimin e anëtarëve të Kishës, Presidenca e Parë ka nxjerrë raportin statistikor që vijon, lidhur me rritjen dhe gjendjen e Kishës deri më 31 dhjetor 2013.

Njësi të Kishës

Kunje	3.050
Misione	405
Distrikte	571
Lagje dhe Degë	29.253

Anëtarësia e Kishës

Anëtarësia e Përgjithshme	15.082.028
Fëmijë të Rinj të Regjistruar	115.486
Të Kthyer të Pagëzuar	282.945

Misionarë

Misionarë Kohëplotë	83.035
Misionarë në Shërbim të Kishës	24.032

Tempuj

Tempuj të Përkushtuar gjatë vitit 2013 (Tempulli i Tegusigalpës në Honduras)	1
Tempuj në Funkionim në Fund të Vitit	141

